REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery	04 . 12	201 8	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7389 /2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.680/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Shkëmb Manaj- kryetar, Lela Petkovic dhe Hajzer Salihu- anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.680/2018, të datës 22.10.2018, së ankuesi Refik Beqiri, me adresë banimi Dregu i Dielllit nga Komuna e Prishtinës, rruga, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike " kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET si e pabazuar** ankesa me numër A. Nr. 680/2018 e datës 22.10.2018, e parashtruar nga ankuesi Refik Beqiri.

II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me 14-070/01-215482/18, i datës 18.09.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 11.04.2018, me numër protokolli 14-118-0084964/18 , ka nxjerr vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Refik Beqiri , duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja me datën 04.09.2018, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, i Komunës së Prishtinës, me datën.18.09.2018, me numër protokolli 14-070/01-21482/18//18, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar në ligj për kompensimin e tri pagave me arsyetimin se një pagave pas moshës së pensionimit për kompensimin e tri (3) pagave me

arsyetimin se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit ligjor ashtu siç është përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ankuesi Refik Beqiri, i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 14-070/01-21482/18//18, të datës 18.09.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, me datën 22.10.2018 parashtron ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e tri (3), pas arritjes së moshës së pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë me datë 23.10.2018 Më datë 06.06.2018 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me provat e bashkangjitura.

Administrimi i Provave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar më datë 22.10.2018, A. Nr. 680/2018 me numër protokolli 6220/2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 18.09.2018, me numër protokolli 14-070/01-215482/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 11.04.2018, me numër protokolli 14-118/02-0084964/18, për përfundimin e marrëdhënies se punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; kërkese për pagesë retroaktive; Përgjigje në ankesë e datës 31.10.2018, me numër protokolli 6460/2018, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Refik Beqiri, ***është e pa bazuar sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstaton se sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil që arrin moshën e pensionimit në shërbimin civil, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumen prej një (1) page mujore të mënjëhershme në vlerën e pagës së fundit, e cila sipas dëshmive në dosje është realizuar nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave nuk ka mundur të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit sepse ankesa e tij në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës, është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor ashtu siç është përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ***"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ".*** Kolegji ka konstatuar se ankuesi është pensionuar me datën 06.05.2018, ndërsa ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave e ka parashtruar me datën 04.09.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës, Vendimin me numër protokolli 14-070/01-21482/18/2018, me datën 18.09.2018, e ka marrë në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 680/2018.

Shkëmb MANAJ
Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Refik Beqiri;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.